



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:238383
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05694700

C.nr.1778/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses H.H., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.Rr., për kompensimin tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, vlera e kontestit 1,439.49 euro, jashtë seance me datë 16.05.2024 mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses H.H., nga Gjakova, përmes të cilës ka kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses së lartcekur në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, të ia paguajë shumën prej 1,439.49 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja H.H., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 27.10.2023, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komuna e Arsimit, për kompensimin tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, duke theksuar se paditësja ka qenë e punësuar si mësimdhënëse e mësimi klasor në SHFMU “...”, ... E njëjta me datë 16.05.2021, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare është pensionuar me Vendimin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës me numër 04-214 i datës 04.05.2023. E paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj konform nenit 35 pika 9 e Kontratës Kolektive të Arsimit nr.01/B, nr.prot.105 e datës 22.01.2021, andaj paditësja ka parashtruar padi kur ka kërkuar që në emër të kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të i paguhet shuma prej 1,439.49 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Vlora Rrahmani, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 16.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi

padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka, nuk i takon as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Tutje ka shtuar se edhe nën supozimin se Kontratave Kolektive do të ishin legjitime, duhet cekur se me datë 21.11.2022 është bërë shkëputja e njëanshme e Kontratave Kolektive, që nënkuptohet se kërkesëpadia e paraqitur për periudhën pas datës së shkëputjes së saj nuk kanë efekt juridik. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja ka qenë e punësuar në shkollën “...” në Guskë, si mësimdhënëse e biologji-kimi deri me datë 16.05.2023 ku të njëjtës i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, fakt i vërtetuar përmes Vendimit Nr.04-214 i datës 04.05.2023 i lëshuar nga Komuna e Gjakovës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për muajin Dhjetor 2021, paga bazë e paditëses ka qenë 421.00 euro. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Në rastin konkret, paditësja kërkesën e saj e ka mbështetur në nenin 35 par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në anën tjetër, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Lidhur me këtë kontratë, gjykata vë në dukje që njëra nga palët kontraktuese dhe atë MASHT, përmes njoftimit numër 01B/488 të datës 21.11.2022 ka deklaruar shkëputjen e kontratës së lartcekur, ndërsa pala tjetër kontraktuese SBASHK nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në drejtim të kontestimit të shkëputjes së kësaj kontrate. Në rrethana të tilla, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të punësuarit e institucioneve publike dhe private të arsimit parauniversitar, shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë, mund të kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre që rrjedhin

nga KKAK, vetëm për periudhën kohore sa ka qenë kjo kontratë në fuqi, pra nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022.

Në këtë rast gjykata ka vërtetuar se paditësja është pensionuar me datë 16.05.2023, pra pas periudhës kur KKAK është shkëputur në mënyrë të njëanshme nga MASHT-i, siç u sqarua më sipër, ashtu që kjo kontratë kolektive nuk prodhon efekt juridik pas datës 21.11.2022, çka do të thotë se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit sipas kriterëve të lartcekura.

Për këtë arsye, gjykata erdhi në përfundim që kërkesëpadia e paditëses është qartazi e pathemeltë, sepse e njëjta është e pa bazuar në ligj apo akte të tjera nën ligjore në fuqi dhe në mungesë të ndonjë akti tjetër juridik në fuqi që e njeh të drejtën e pretenduar të paditësit, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri sipas nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr.1778/23, datë 16.05.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.